

LIGJ
Nr.10 072, datë 9.2.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizime”, në shkronjën “b” të pikës 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nënndarjen “iii”, fjalët “shoqëri tregtare, e themeluar sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”” zëvendësohen me fjalët “shoqëri tregtare, e themeluar sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””.

b) Në nënndarjen “iv”, fjalët “format e parashikuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”” zëvendësohen me fjalët “format e parashikuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””.

Neni 2

Në nenin 8/1 “Të ardhurat e përjashtuara”, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish të dënuarit politikë.”.

Neni 3

Në nenin 12/3, shkronja “II” fjalët “mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”” zëvendësohen me fjalët “mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 4

Në nenin 19 “Fitimi i tatueshëm”, fjalët “në përputhje me ligjin nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”” zëvendësohen me fjalët “në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare””.

Neni 5

Në nenin 21 “Shpenzime të panjohura” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1 shkronja “nj”, fjalët “mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”” zëvendësohen me fjalët “mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

b) Në pikën 3, fjalët “që nuk janë themeluar sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për

shoqëritë tregtare”” zëvendësohen me fjalët “që nuk janë themeluar sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””.

Neni 6

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23 **Inventari**

Njohja fillestare (me kosto) dhe vlerësimi i inventarit, në fund të periudhës tatimore, bëhen sipas metodave të përcaktuara në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë sistematike.

Zhvlerësimi dhe rivlerësimi i inventarit, pas njohjes fillestare, sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ky rregull zbatohet edhe për aktivet financiare dhe aktivet jomateriale.”.

Neni 7

Në nenin 25 “Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit”, fjalët “të krijuara në përputhje me ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”” zëvendësohen me fjalët “të krijuara në përputhje me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime””.

Neni 8

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26 **Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin**

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.”.

Neni 9

Në nenin 33/1 “Destinimi i fitimit”, në pikën 1 fjalët “në përputhje edhe me dispozitat e nenit 56 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar” zëvendësohen me fjalët “sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6073, datë 27.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi